REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1689/4
Data/Datum/Date: 05/11/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A (2025)

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr.270 /2026
Datë: 04.11.2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 11, nenit 29 dhe nenit 30 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në bazë të nenit 10, nenit 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 4 (paragrafi 5 dhe 7) dhe nenin 5 të Rregullores QRK-Nr.12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores QRK-Nr. 08/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1.Emërohet ekipi punues për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së Shërbimit Korrektues të Kosovës në Ministrinë e Drejtësisë, si në vijim:
- 1.1. Lulzim Beqiri, DL/MD ;
- 1.2. Nexhat Syla, DBF/MD
- 1.3. Valmira Uka, DL/MD;

2. Emërohet ekipi punues për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së Shërbimit Sprovues të Kosovës në Ministrinë e Drejtësisë, si në vijim:
- 2.1.Arta Nuredini BNJ/MD;
- 2.2.Mimoza Blakaj - Pitaqi, DPSDPLS/MD;
- 2.3.Resul Jashari, DFSHP/MD;

3. Emërohet ekipi punues për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar në Ministrinë e Drejtësisë, si në vijim:
- 3.1.Bahri Beqiri, DFSHP/MD;
- 3.2.Rinor Gjergji, DL/MD;
- 3.3.Samire Shabani, DBF/MD;

4. Emërohet ekipi punues për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së Avokaturës Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, si në vijim:
- 4.1. Gazmend Çitaku, DBNJ/MD;
- 4.2. Fjolla Sojeva - Sopa, DBF/MD;
- 4.3. Muhamet Krasniqi, DBJN/MD;

5. Emërohet ekipi punues për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë, si në vijim:
- 5.1.Ilir Gutaj, DQD/MD;
- 5.2.Bekim Agushi, DBF/MD
- 5.3.Erëza Ibrahimi DL/MD;

6. Emërohet ekipi punues për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së Institutit për Mjekësinë Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë, si në vijim:

6.1.Selvije Elezaj, DIEKP/MD;
6.2.Burbuqe Spahija, DPL/MD;
6.3.Arlinda Alshiqi, DL/MD.

7. Emërohet ekipi punues për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së Inspektoratit për Mbikëqyrjen e Punës së Institucioneve Korrektuese dhe Drejtorive Rajonale Sprovuese në Ministrinë e Drejtësisë, si në vijim:

7.1. Taulant Sejdiu, DBJN/MD;
7.2. Vjollca Humolli, DBF/MD;
7.2. Kaltrina Nuhiu, DL/MD.

8. Obligohen ekipet punuese sipas pikës 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ti kryejnë në pajtim me legjislacionin në fuqi përkatësisht dispozitat relevante të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe Rregullores QRK Nr. 13/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në Kuadër të Administratës Shtetërore.

9. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi Nr. 223/2023 i datës 15.12.2023 për Emërimin e Ekipeve punuese (njësive përgjegjëse) për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së Agjencive Ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë, Vendimi Nr. 435/2024 të datës 16.12.2024 si dhe Vendimi Nr. 429/2025 të datës 16.12.2025.

10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Donika Gërvalla – Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të ekipeve punuese;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Agjencive ekzekutive përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*